

VENDIM
Nr. 7, datë 27.6.2022

**PËR MIRATIMIN E MARZHEVE NË BAZË TË MONITORIMIT TË ÇMIMEVE
PËR PRODUKTET USHQIMORE BAZË DHE PRODUKTET E TJERA TË LIDHURA
ME TO, SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG**

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Produkteve Ushqimore Bazë dhe Produkteve të Tjera të Lidhura me To, në zbatim të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”,

VENDOSI:

1. Miratimin e marzheve që do të aplikohet për produktin ushqimor bazë sheqer, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar nga rritja e çmimeve ndërkombëtare.
2. Për artikullin sheqer (1 kg) miratohen marzhet, si më poshtë:
 - a) Marzhi tavan i tregtimit të shitjes me shumicë të sheqerit nga importuesi dhe ambalazhuesi është 15 lekë/kg (6 lekë/kg për importuesin dhe 9 lekë/kg për ambalazhuesin) mbi koston e importit plus detyrimet e paguara në doganë.
 - b) Marzhi i tregtimit të transportuesit i cili mund të jetë shitësi me shumicë, shitësi me pakicë apo palë të treta, nga magazina e shitësit me shumicë te magazina e shitësit me pakicë është 2 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur sipas gërmës “a” të këtij paragrafi.
 - c) Marzhi i tregtimit të shitjes në njësitë e tregtimit me pakicë të produktit sheqer është 3 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur sipas gërmës “a” të këtij paragrafi plus transportin, sipas gërmës “b” të këtij paragrafi.
3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha subjektet, që tregtojnë me shumicë/pakicë produktin e përcaktuar në këtë vendim.
4. Në pasqyrën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi jepen të dhënat në lidhje me përlllogaritjet e çmimit tavan të tregtimit, sipas marzheve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datë 27.6.2022 dhe i shtrin efektet deri në mbledhjen e ardhshme të Bordit. Ky vendim do të publikohet në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Frida Krifca, Ceno Klosi, Irfan Tarelli, Genti Gazheli, Jeta Deda, Nikolla Lera, Fuad Haxhiymeri, Vjollca Ferra, Elona Hametaj Mema, Gentian Celo, Majlinda Bajraktari, . Ermal Babameto

Pasqyra nr. 1.

Përshkrimi	Kostoja mesatare e ponderuar në import dhe pagesa në doganë (zhdoganimi 10–24 qershor 2022)	Marzhi në import/shumicë	Marzhi me shumicë (importuesi i ndryshëm nga shitësi me shumicë)	Marzhi i transportuesit	Marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë	Çmimi tavan në njësitë e tregtimit me pakicë	Sqarime
------------	---	--------------------------	--	-------------------------	---	--	---------

Sheqer	94 lekë/kg	6 lekë/kg	9 lekë/kg	2 lekë/kg	3 lekë/kg	114 lekë/kg	Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Çmimi tavan i tregtimit për këtë produkt do të jetë 114 lekë/kg.
--------	------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-------------	--